



## PROCESVERBAL

Sot më datë 13.9.2021, ora 11.00, Komisioni për administrimin e procesit të votimit për përzgjedhjen e kandidatëve nga trupa e personelit akademik me kohë të plotë të FDUT për anëtarë të KLGJ dhe kandidatëve për anëtarë të KLP, i ngritur më Urdhërin nr.64, datë 09.09.2021 (shkresa nr.629/9 Prot., datë 9.9.2021), i përbërë nga:

Erind MERKURI  
Valbona NDREPEPAJ  
Inva ÇELA KOÇIAJ

Në prani dhe të vëzhgueses nga Ministria e Drejtësisë, znj.Aida Shehi, Drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë caktuar më shkresën nr.4466 Prot., datë 13.9.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm, administroi procesin e votimit.

Në këtë proces proces morën pjesë në total 80 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe konkretisht, nga:

Departamenti Civil,	28 anëtarë
Departamenti Penal,	27 anëtarë
Departamenti Publik,	25 anëtarë
<b>Totali</b>	<b>80 anëtarë</b>

Nga ana e Komisionit u printuan 80 flete votimi, por rezultoi se dy prej tyre, që i përkisnin procesit të votimit për kandidatët për anëtarë të KLGJ-së, dolën të dëmtuara. Mbi këtë bazë nga ana e Komisionit u bë riprintimi i dy fletëve të tjera votimi për procesin e votimit për anëtarë të KLGJ-së dhe dy fletet e dëmtuara u asgjësuan në prani të kandidatëve.

Pjesëmarrja e anëtarëve vërtetohet nga listëprezanca dhe nënshkrimet përkatëse të secilit anëtar, që i bashkëlidhen këtij procesverballi dhe janë pjesë përbërëse të këtij procesverballi.

Secili prej anëtarëve të pranishëm u thirr sipas renditjes në listëprezencë dhe kundrejt nënshkrimit të tij, duke filluar fillimisht me listëprezencën e Departamentit të së Drejtës Civile dhe me pas me listën prezencën e Departamentit të së Drejtës Penale dhe në fund atë të Departamentit të së Drejtës Publike.

Secili prej anëtarëve u pajis me dy fletë votimi një për listën e kandidatëve për KLGJ dhe një për listën e kandidatëve në KLP. Lista e kandidave ishte përcaktuar më vendim të Dekanatit si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I TIRANES  
FAKULTETI I DREJTESISË



Rruga "Mito TUTULANI", Tirana, ALBANIA Tel/Fax. + 355 4 222 537, <http://www.fd-ut.edu.al>

Lista e kandidatëve për KLGJ:

Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi  
Prof.Asoc.Dr. Oriona Muçollari  
Prof.Asoc.Dr. Besnik Çerekja  
Dr. Alban Koçi

Lista e kandidatëve për KLP:

Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi  
Dr. Alban Koçi

Me përfundimin e votimit, në prani të kandidatëve dhe vëzhgueses, u hap fillimisht kutia e votimit për anëtarë të KLGJ-së nga ku rezultoi:

Fletëvotimi gjithsej	80 copë
Të vlefshme	76 copë
Të pavlefshme	4 copë

Komisioni konstatoi se në këtë kuti votimi 74 fletë votimi ishin për anëtar të KLGJ dhe dy fletë votimi ishin hedhur gabim dhe i përkisnin kutisë së votimit për anëtar të KLP-së.

Tek kutia e votimit për anëtar të KLGJ-së, votat ishin ndarë si më poshtë:

Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi	21 vota
Prof.Asoc.Dr. Oriona Muçollari	16 vota
Prof.Asoc.Dr. Besnik Çerekja	9 vota
Dr. Alban Koçi	28 vota

Votat e pavlefshme u konsideruan të tilla nga ana e komisionit pasi në to ishte shënuar më shumë se një alternativë.

Më pas, në prani të kandidatëve dhe vëzhgueses, u vijua me hapjen e kutisë së votimit për anëtarë të KLP-së nga ku rezultoi:

Fletëvotimi gjithsej	80 copë
Të vlefshme	74 copë
Të pavlefshme	6 copë



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I TIRANES  
FAKULTETI I DREJTESISE



Rruga "Mito TUTULANI ", Tirana , ALBANIA Tel/Fax. + 355 4 222 537, <http://www.fd-ut.edu.al>

Komisioni konstatoi se në këtë kuti votimi 72 fletë votimi ishin për anëtar të KLP dhe dy fletë votimi ishin hedhur gabim dhe i përkisnin kutisë së votimit për anëtar të KLGJ-së.

Tek kutia e votimit për anëtar të KLP-së, votat ishin ndarë si më poshtë:

Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi	34 vota
Dr. Alban Koçi	38 vota

Votat e pavlefshme u konsideruan të tilla nga ana e komisionit pasi në to, në 5 raste ishte shënuar më shumë se një alternativë, kurse në një rast nuk ishte shënuar asnjë alternativë (flete votimi e paplotësuar).

Përsa i përket fletevë të votimit të hedhura gabim, Komisioni konstatoi se ato ishin në rregull, në formë, format, madhësi si edhe vullneti i anëtarit votues ishte shprehur qartë. Në këtë rast të gjithë fletet, 2 për anëtar të KLGJ-së dhe 2 për anëtar të KLP-së ishin për kandidatin Ilir Rusi, i cil vlerësohet me 23 vota si kandidat për anëtar i KLGJ-së dhe 36 vota si kandidat për anëtar i KLP-së.

Ndodhur në këtë situatë dhe përpara një gabimi njerëzor, Komisioni vendosi që edhe këto vota t'i shtojë këtij kandidati. Në përfundim, rezultati për secilin kandidat ëhstë si më poshtë:

Për kandidatët për anëtar të KLGJ-së:

Dr. Alban Koçi	28 vota
Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi	23 vota
Prof.Asoc.Dr. Oriona Muçollari	16 vota
Prof.Asoc.Dr. Besnik Çerekja	9 vota

Për kandidatët për anëtar të KLP-së:

Dr. Alban Koçi	38 vota
Prof.Asoc.Dr. Ilir Rusi	36 vota

Procesi u mbyll nga Komisioni në orën 13.27.

Ky procesverbal hartohet në 10 kopje.

KOMISIONI

Inva ÇELA KOÇIAJ

Valbona NËREPEPAJ

Erind MERKURI